



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë më, 28 Shtator 2016

RAPORT MBI GJETJET E MONITORIMIT TË PJESSHËM

PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË DIBËR, QARKU DIBËR

Hyrje

Në përmbushje të misionit të tij, KShH ka monitoruar të gjitha proceset zgjedhore të zhvilluara në Shqipëri, që nga viti 1996, duke vlerësuar respektimin e zbatimit të standardeve të Kopenhagenit, të së drejtës kushtetuese për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, si dhe ka përgatitur e prezantuar raporte lidhur me gjetjet dhe rekomandime për përmirësimin e situatës në këto drejtime.

Në datën 11 Shtator 2016 u zhvilluan zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, Qarku Dibër, sipas Dekretit të Presidentit nr.9716, datë 02.08.2016. Për administrimin e zgjedhjeve u krijua **Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor nr.19** dhe u krijuan **118 Qendra Votimi**. Në këto zgjedhje u regjistruan dy subjekte zgjedhore ai i majtë “Aleanca për Shqipërinë Evropiane”, i drejtuar nga Partia Socialiste dhe koalicioni i djathtë, “Aleanca popullore për Punë dhe Dinjitet”, i drejtuar nga Partia Demokratike.

Në listën përfundimtare të zgjedhësve u regjistruan, gjithsej, **57.018 zgjedhës** (sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile), prej të cilëve votuan **33 978 zgjedhës, ose 60 % e tyre**.

Regjistrimi i subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre u krye në afatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor. U regjistruan **2 kandidatë për kryetar bashkie**.

Për shkak të mundësive të kufizuara, shtrirja e monitorimit të këtyre zgjedhjeve nga KSHH ka qenë relativisht e kufizuar. **Konkluzionet tona jepen mbi bazën e informacionit që kemi marrë në mënyrë të drejtpërdrejt nga vëzhgimi i kryer në terren.**

Për monitorimin e zgjedhjeve të 11 Shtator 2016, KShH aktivizoi 6 vëzhgues afatgjatë, të gjithë të akredituar, sipas ligjit, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Vëzhguesit u trajnuan, paraprakisht, lidhur me aspektet më të rëndësishme të Kodit Zgjedhor (KZ), si dhe lidhur me metodologjinë e monitorimit, që do të aplikohet për vëzhgimin e zgjedhjeve për kryetarin e Bashkisë Dibër. Në dispozicion të vëzhguesve u vunë pyetësorë dhe materiale të tjera të nevojshme për realizimin dhe mbarëvajtjen e vëzhgimit.

Monitorimi i procesit zgjedhor u shtri pjesërisht në disa fazat e tij, sa i takon çështjeve parazgjedhore, votimit dhe numërimit të votave. Ditën e votimit KShH **monitoroi 19 qendra votimi, nga 118 gjithsej, të përfshira në Komisionin Zonal të Administrimit Zgjedhor nr. 19 në Bashkinë e Dibrës.**

KShH falënderon të gjithë vëzhguesit, për profesionalizmin, paanshmërinë dhe përkushtimin e tyre.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

1. MONITORIMI I PJESSHËM I DISA ÇËSHTJEVE TË NATYRËS PARAZGJEDHORE

- 1.1** Në periudhën para zgjedhore situata e sigurisë dhe rendit publik ishte e qetë, por klima politike ishte relativisht e tensionuar, për shkak të akuzave reciproke të përfaqësuesve të koalicioneve, të krijuara në kuadër të zgjedhjeve. Pretendohej për presion, angazhim të administratës publike të institucioneve të kësaj bashkie në fushatën zgjedhore, blerje vote, etj.
- 1.2 Listat e zgjedhësve ishin të një cilësie më të mirë se më parë.** Nga monitorimi u raportua se kërkesat për ndryshimin e përbërësve zgjedhorë në listat paraprake kanë qenë relativisht të pakta. Në listat përfundimtare të zgjedhësve u **përfshinë 57, 018** shtetas me të drejtë vote, nga të cilët kanë **votuar 33, 978 zgjedhës, ose 60 %** e tyre.
- 1.3** Listat e zgjedhësve janë shpallur në datë 15.08.2016. Megjithatë, nga verifikimi në terren, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se listat e zgjedhësve të afishuara në QV të monitoruara nuk përmbanin datën e shpalljes së tyre. Kryesisht, në 2-3 raste ka pasur pretendime për mungesën e emrit në listat e zgjedhësve për të cilat është proceduar duke dhënë vërtetimin përkatës të KZAZ-së dhe janë orientuar shtetasit për t'ju drejtuar gjykatës. Gjate verifikimit rezultoi se listat e zgjedhësve ishin shpallur në të gjitha QV të monitoruara me përjashtim të QV nr. 1145, të vendosur në objektin privat Bar Bufo. Grupi i parë i vëzhguesve të KShH-së konstatoi se kjo qendër votimi ishte në kushte të papranueshme të higjienës, lagështirës, amortizimit të ndërtesës dhe papërshtatshmërisë me standardet e kërkuara për procesin e votimit që pritej të zhvillohej.
- 1.4** Në disa raste, listat e zgjedhësve u vendosën në vende të papërshtatshme dhe të pa- aksesueshme lehtësisht nga zgjedhësit ose ishin vendosur pranë ambienteve publike, kryesisht arsimore, të cilat në orët e pasdites ishin të mbyllura dhe nuk mundësonin shikimin e lirshëm të listave nga shtetasit.

2. ADMINISTRIMI ZGJEDHOR

- 2.1** Në bazë të ligjit, administrimi i zgjedhjeve realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) dhe Grupet e Numërimit të Votave (GNV). Duket se cilësia e trajnimit dhe ndryshimi i shpeshtë i komisionerëve janë faktorë që ndikuan në mungesën e aftësive dhe njohurive relativisht të pakta mbi rregullat e administrimit të zgjedhjeve.
- 2.2** Administrimi zgjedhor, megjithëse në një masë më të reduktuar, tregoi përsëri se caktimi i anëtarëve të organeve të administrimit të zgjedhjeve nga partitë politike parlamentare, passjell ndikimin partiak të tyre, njëanshmëri dhe moszbatim rigoroz të ligjit. Krijimi i komisioneve zgjedhore me propozimin e partive politike (subjekte zgjedhore) ka ndikuar dhe ndikon negativisht, nxit politizimin brenda komisioneve. Prandaj, me të drejtë, në raportet e fundit të OSBE/ODIHR-it kërkohet de politizimi i organeve të administrimit zgjedhor.

2.3 Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor (KZAZ 19)

- 2.3.1 KZAZ nr.19 u ngrit në kohë dhe brenda afatit ligjor.** KZAZ-ja kishte të afishuar në derën e zyrës përbërjen e komisionit, orarin e veprimtarisë dhe rendin ditës së mbledhjet e planifikuara. Kjo tregon transparencën e veprimtarisë dhe vendim-marrjes së këtij organi.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- 2.3.2 Nuk ka pasur ndryshime apo zëvendësime të anëtarëve të KZAZ-së para dhe pas procesit të votimit por ndërkohë ka pasur zëvendësime të vazhdueshme të anëtarëve të Grupeve të Numërimit dhe të anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit. Rezulton të jenë marrë 116 vendime zëvendësimi për anëtarët e QV-ve. Vlen të përmendet se zëvendësime janë bërë edhe ditën e fundit.
- 2.3.3 Trajnimi i kësaj KZAZ-je ishte realizuar në dt. 13 Gusht 2016, përkatësisht një ditë pas konstituimit të saj.

2.4 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

- 2.4.1 Në përgjithësi, KQZ ka zbatuar drejt dispozitat e Kodit Zgjedhor, ka ushtruar kontrole të vazhdueshme dhe herë pas here ka informuar publikun mbi pengesat dhe ecurinë e zgjedhjeve.
- 2.4.2 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte ngritur 4 grupe trajnimi për anëtarët e KQV-ve dhe GNV-ve, të vendosura në objekte të ndryshme të kësaj bashkie si Maqellarë, Tomin, etj.
- 2.4.3 Si rregull kërkohet që pasi të tërhiqej baza materiale, anëtarët e KQV-ve duhet t'i nënshtroheshin trajnimit. Në fakt, është vënë re që pas marrjes së bazës material zgjedhore ku ndodheshin dhe manualët e KQV-ve, disa nga anëtarët e KQV-ve u larguan nga KZAZ-ja.
- 2.4.4 Referuar informacionit të marrë nga KQZ, rezulton se trajnimet kanë filluar në dt. 07.09.2016, datë në të cilën nuk është paraqitur për trajnim asnjë anëtar i KQV-ve dhe GNV-ve megjithëse ishin njoftuar nga KQZ. Ndërsa, në dt. 08.09.2016, në këtë Shkollë janë paraqitur për trajnimin 60 anëtarë të KQV dhe GNV, ndërsa nuk disponohej informacion mbi numrin e anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve të trajnuara në objektet e tjera. Në dt. 09.09.2016 nuk është paraqitur për trajnim asnjë anëtar i KQV-ve dhe GNV-ve, pasi, sikurse na u komunikua, ka qenë data përmbyllëse e fushatës zgjedhore nga subjektet politike garuese.
- 2.4.5 Sipas informacionit të marrë nga KZAZ nr.19, deri në orën 19.00 të datës 10.09.2016 kishin mbetur vetëm 10 qendra votimi (QV), për të cilat, KQZ nuk kishte shpërndarë ende bazën materiale. Vëzhguesit e KShH-së konstatuan se për disa QV në qytetin e Peshkopisë, nuk kishte mbërritur ende baza materiale, përkatësisht në QV nr. 1136/1, QV nr. 1135/1, QV nr. 1140 dhe QV 1140/1. Për dy qendrat e fundit të votimit, punonjësi i kontaktuar i policisë së shtetit i ka komunikuar vëzhguesve të KShH-së se nuk është tërhequr baza materiale për shkak të ndryshimit të anëtarëve të KQV-ve). Rrjedhimisht, KQZ nuk garanoi që të gjitha materialet zgjedhore të përgatiteshin në sasinë e cilësinë e duhur dhe nuk realizoi shpërndarjen e tyre brenda afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor. Nga verifikimi në terren i këtyre qendrave të votimit, në intervalin 16.00 - 18.30 u vërejt prania e punonjësve të Policisë së Shtetit, madje edhe në ato QV që nuk kishin mbërritur ende materialet zgjedhore.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

3. MONITORIMI I PJESSHËM I PROCESIT TË VOTIMIT

- 3.1** Përgjithësisht, QV-të ishin të vendosura në institucione publike dhe shtetërore si , shkolla, kopshte, institucione shëndetësore, sportive dhe në disa raste në lokale private. Ditën e zgjedhjeve, procesi i votimit ka vijuar përgjithësisht pa ndërprerje.
- 3.2** Klima dhe situata ditën e votimit ka qenë në përgjithësi e qetë dhe nuk janë konstatuar incidente në qendrat e monitoruara. **Sjellja e zgjedhësve ishte e mirë.** Ata votuan të qetë dhe përgjithësisht respektuan rregullat e procesit.
- 3.3** Sa i përket orarit, rezultoi se pjesa më e madhe e qendrave të monitoruara të votimit u hapën në orën 07:00 të mëngjesit konform parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Vëzhguesit konstatuan vonesa të hapjes së qendrave të votimit në 3 prej tyre, përkatësisht në QV nr. 1143/1, 1146 dhe 1136. Në QV. 1136 dhe QV. 1146 procesi zgjedhor filloi me vonesë për shkak të zëvendësimit të një prej anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit (KQV). Në QV nr.1146 rezultonte se Vendimi nr.320 date 10.09.2016 "Për lirim dhe emërim të anëtarit të KQV", ishte miratuar brenda 24 orëve të fundit nga procesi i votimit në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Këto vonesa shkaktuan radhë tek zgjedhësit që u paraqitën për të votuar në këto qendra votimi.
- 3.4** Sa i takon respektimit të procedurave të votimit nga anëtarët e KQV-ve u vërejt se, nuk respektohej gjithmonë rregulli i kontrollit të dy duarve të zgjedhësve para votimit (QV. 1146, 1145 dhe 1141/1), nuk respektohej gjithmonë heqja e emrit në listë me vizë për zgjedhësit të cilët votonin (QV. 1144/1 dhe 1145) dhe nuk tumbrohej gjithmonë dora e majtë (QV. 1146). Në QV. 1140, anëtarët e KQV citonin me zë të lartë numrin rendor të zgjedhësit që votonte me qëllim informimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore politike, mbi personin që po votonte. Pas diskutimeve të zhvilluara në këtë QV lidhur me këtë praktikë nga KQV, ajo u ndalua.
- 3.5** Në QV 1144 dhe 1146 është lejuar të votojë një zgjedhës, të cilit nuk i korrespondonte mbiemri në listën e zgjedhësve me mbiemrin në kartën e identitetit dhe një shtetas që u identifikua me një pasaportë italiane.
- 3.6** Vlen të evidentohet fakti se disa votues nuk gjenin emrin e tyre në listat e zgjedhësve si në QV 1146, madje, në ndonjë rast edhe pse ishin anëtarë të një familje, rezultoi që një prej familjarëve të ketë votuar në këtë QV, ndërkohë që pjesës tjetër u është komunikuar që figuronin në listën e zgjedhësve të QV pranë. Në këto raste, KQV udhëzoi personat që nuk gjenin emrin në listë të shkonin për të votuar në QV pranë.
- 3.7** Nga ana e vëzhguesve të KShH është evidentuar fakti se në mjaft raste u konstatua se zgjedhësit hynin në dhomat e fshehta të votimit duke mbajtur aparatet telefonike në mënyrë të dukshme. Janë konstatuar 4 raste të fotografimit të votës (p.sh. në QV. 1141/1, 1142 dhe 1141). Në 2 prej këtyre rasteve, votuesit iu tërhoq vëmendja por nuk iu dha flete votimi tjetër duke quajtur të vlefshme fletën e votimit. Kjo praktikë ishte në kundërshtim me nenin 107, pika 1 të Kodit Zgjedhor, pasi kjo fletë votimi duhej të quhej e dëmtuar dhe zgjedhësit t'i jepej një tjetër fletë votimi.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- 3.8** Janë konstatuar disa raste konkrete kur zgjedhësi pretendonte se nuk mund të votonte për shkak të paaftësisë fizike dhe mendore dhe për këtë u ndihmua nga një i afërm i tij QV 1143, 1146 dhe 1143/1). KQV nuk kanë respektuar gjithmonë procedurën e parashikuar nga neni 108 në këto raste. Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar vetëm një rast ku rezultoi të jetë paraqitur librezja e invaliditetit pranë KQV për një person që nuk mund të votonte. Pjesa më e madhe e personave, për të cilën votuan familjarët pretendonin se nuk mund të votonin për arsye se kishin probleme me shikimin. Gjithashtu u konstatuan 3 raste ku një person votoi për 2 persona të paaftë fizikisht për të votuar. Një tjetër problematikë e vërejtur nga monitorimi konsistonte tek fakti se, familjarët gjate momentit të votimit në dhomat e fshehta komunikonin dhe udhëzonin të afërmit e tyre për të votuar në mënyre të caktuar.
- 3.9** Në QV e monitoruara vëzhguesit tanë kanë konstatuar se anëtarët e KQV votuan në mëngjes ose gjatë ditës dhe jo në fund të procesit të votimit, siç parashikohet në Kodin Zgjedhor.
- 3.10** Gjatë mbylljes së votimit, në QV. 1143/1 dhe 1146 u konstatua se kishte mungesë të kopjeve të procesverbaleve të mbylljes së votimit të dërguara nga KQZ, pasi disponoheshin përkatësisht vetëm 4 kopje dhe 3 kopje, duke mos pasur mundësi që 7 anëtarët e KQV-së dhe vëzhguesit e subjekteve politike (edhe pse ishin të interesuar), të pajiseshin me këtë procesverbal, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.
- 3.11** Procesi i votimit, përgjithësisht u mbyll në kohë, në orën 19:00. Përfundimi i procesit zgjedhor, përgjithësisht, është kryer në orën dhe mënyrën e parashikuar në ligj.
- 3.12** Procesi i shoqërimit të kutive me dokumentacionin e QV-ve u krye duke respektuar procedurat e parashikuara në Kodin Zgjedhor. U konstatua se kutitë e votimit u dërguan në KZAZ menjëherë pas mbylljes së procesit të votimit. Në disa raste, sikurse ishte rasti i kutive të votimit të njësisë administrative të Lurës, dorëzimi i kutive ka përfunduar rreth orës 10:30, duke mos respektuar afatin 3 orë për dorëzimin e tyre pas mbylljes së orarit të votimit.
- 4. MONITORIMI I PJESSHËM I PROCESIT TË NUMËRIMIT**
- 4.1** Numërimi i votave nuk filloi në kohën e parashikuar në ligj, për shkak të vonësës në dorëzimin e kutive dhe mos trajnimit në kohë të disa anëtarëve të GNV-ve.
- 4.2** Në orën 23:05 të datës 11 Shtator, anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) janë futur në vendin e numërimit, Palestrën e Shkollës së Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti", dhe janë udhëzuar (trajnuar) për mënyrën e numërimit të votave. Gjithsej, ishin 8 grupe numërimi me nga katër anëtarë dhe nuk u konstatuan vonesa të mëdha në formimin e tyre në tryezat përkatëse. Do të ishte më e rregullt dhe më e efektshme nëse trajnimi i numëruesve do të kryhej më parë.
- 4.3** Procesi i numërimit të votave ka filluar në orën 23:45 të datës 11 Shtator, pas urdhrorit të dhënë nga Kryetari i KZAZ nr. 19. Me vendim të KZAZ-së, numërimi i votave ka filluar nga kutia me numrin më të vogël rendor në listën e QV.
- 4.4** KZAZ-ja vendosi për largimin e vëzhguesve të paautorizuar nga ambient i vendit të numërimit, vetëm pas ndërhyrjes së një përfaqësuesi të një subjekti zgjedhor tek një anëtar i KZAZ-së. Menjëherë pas kësaj, KZAZ-ja mori vendim për largim nga VNV-ja të të gjithë personave të



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

paautorizuar nga subjektet zgjedhore, me ndihmën e forcave të Policisë së Shtetit. Fillimisht ky vendim i KZAZ-së u zbatua, por gjatë orëve në vijim problemi u konstatua sërish. Pjesëmarrja e lartë e personave të paautorizuar që vëzhgonin procesin e numërimit të votave ndikonte në vështirësimin e kushteve objektive për të monitoruar në mënyrë të plotë këtë proces nga vëzhguesit e autorizuar.

- 4.5 Deri në orën 04.25 të dt. 12.09.2016 janë numëruar gati 1/3 e kutive të votimit të 118 QV. Në këtë orë u ndërpre procesi i numërimit për të rifilluar sërish në orën 10.00.
- 4.6 Ne ambientin e numërimit të votave nuk është vërejtur prezencë e forcave të policisë së shtetit, të cilët ndodheshin jashtë perimetrit të brendshëm të godinës, përtej derës së jashtme të palestres, duke mbajtur rendin dhe sigurinë e procesit. Policia ka qenë në gatishmëri për ruajtjen e rregullit dhe rendit, duke mbikëqyrur QV por duke ruajtur distancën e duhur prej tyre.
- 4.7 Ne palestër u lejua futja e vëzhguesve të pavarur, kryesisht nga organizata jofitimprurëse, të subjekteve zgjedhore politike, të medias, deputetë të forcave politike, etj. Mediat pasqyruan gjerë procesin zgjedhor.
- 4.8 Procesi i numërimit filloi me hapjen e kutive të votimit, sistemimin e tyre sipas një rregulli dhe leximin e votës nga anëtarët e GNV-ve dhe vëzhguesit e pranishëm përmes monitorëve për këtë qëllim. Gjatë numërimit, fletët e votimit të pavlefshme mbaheshin mënjanë.
- 4.9 Gjatë numërimit të votave është konstatuar se cilësoheshin të vlefshme fletët e votimit në të cilat shënimi ndodhej jashtë kutisë së bardhë të përcaktuar, ose përbri emrit të kandidatit për Kryetar Bashkie.
- 4.10 Pas numërimit, materialet zgjedhore (fletët e votimit, procesverbalet, etj.) mbylleshin edhe një herë në kutinë e votimit me kodet e reja të sigurisë të vendosura nga GNV.
- 4.11 Gjatë procesit të numërimit të votave u konstatua zëvendësimi i vazhdueshëm i anëtarëve të GNV-ve, kryesisht për shkak të lodhjes, fakt i cili u konfirmua edhe nga kryetari i KZAZ-së .
- 4.12 Nga monitorimi rezultoi se ka pasur komunikim të vazhdueshëm midis anëtarëve të GNV-ve me vëzhguesit e subjekteve politike zgjedhore, veçanërisht deputetëve të pranishëm, me pusulla letrë apo komunikim verbal, sa i takon rezultateve të numërimit. Kjo praktikë ishte në shkelje të procedurave të parashikuara në Kodin Zgjedhor ku parashikohet se *“Në rast se nga verifikimet e kryera konstatohen mospërputhje, atëherë Grupi i Numërimit ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, që bën konstatimin, njofton menjëherë KZAZ-në për mospërputhjet. Njoftimi bëhet me ngritjen e dorës dhe pa lëvizur nga vendi. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë”*. KShH vlerëson se kjo praktikë e ndjekur është gjithashtu tregues i politizimit të theksuar të administratës zgjedhore.
- 4.13 Në KZAZ, procesi i numërimit përfundoi në orën 18:10 të datës 12 Shtator, me numërimin e kutisë së fundit të votimit, që i përkiste njësisë administrative Reç, Bashkia Dibër. Ne orën 18:30 KZAZ nr. 19 plotësoi proces-verbalin e mbylljes së numërimit, gjithsej për 118 kuti votimi, proces-verbalet e të cilave u dërguan nëpërmjet teknikës në KQZ. Ky proces-verbal



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KZAZ-së, sipas Librit të Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së.

4.14 Në përgjithësi, konstatohet se procesi i numërimit ka vazhduar tej afatit ligjor, duke shkaktuar një zgjatje të procesit të numërimit. Megjithatë, vlen të evidentohet si progres fakti se ky proces ka zgjatur më shpejt se në zgjedhjet e kaluara. Në shumë raste procesi i numërimit është ndërprerë herë pas here, pasi anëtarët e GNV-ve kanë kërkuar kohë pushimi për t'u çlodhur, ose nevoja të tjera vetjake.